REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 212/19
Datë/Datum. 05.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit AK –K.Klinë	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	*Xhevdet Bushi – Ekspert i jashtëm shqyrtues i prokurimit*		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me:**Nr.212/19nga OE. "Proing&Partners"– Prishtinë**		
Datë	03.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e **dt.15.05.2019 me nr.212/19të parashtruar ngaOE. "Proing&Partners"– Prishtinëlidhur** me aktivitetine prokurimit **"Hartimi i projekteve zbatuese - ekzekutive"** me nr. të prokurimit: **634-19-502-221**, iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E KLINËS (KK)**
AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:
- ***Autoritetit Kontraktues – Komuna Klinë***
- ***Panelit Shqyrtues – OSHP***
- ***OE ankues*"Proing&Partners"– Prishtinë**

Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEË BODY

RAPORTIIEKSPERTIT SHQYRTUES

		22.05.2019		**22.05.2019**		**03.06.2019**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të eksp.*		*data e fillimit të ekspertizës*		*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

1) Me datë **15.05.2019 me nr. 212/19 të parashtruar ngaOE. "Proing&Partners"– Prishtinë**
2) Lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Hartimi i projekteve zbatuese-ekzekutive"** me nr. të prokurimit: **634-19-502-221**, iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E KLINES (KK)**

N.111,LPP-Operatori Ekonomik AnkuesOE "Proing&Partners"–Prishtinë (Nr.212/19)

Pikat e Ankesës:

- Më datën:25.02.2019 është bërë shpallja e tenderit në faqen elektronike të KRPP-së;
- Data e dorëzimit të tenderit: 20.03.2019
- Data e hapjes së tenderit: 20.03.2019;
- Kriter për dhënie të kontratës ka qenë „tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët".
- Kërkesa për ri-shqyrtim/AK-02.05.2019
- Përgjigjja përmes e-mailit/AK-07.05.2019

Dispozitat e shkelura (pretendimet ankimore)nga AK sipas OEankues (Nr.212/19)janë:

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia ne trajtim/Jo-diskriminimi
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 64 Deshmite e kërkesave

Neni 69 Aftesia Teknike dhe/ose profesionale
Neni 28 i RRUOPP
Neni 41 i RRUOPP

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet
Me datë 26.04.2019 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me Letër Standarde për Tenderuesin e pasuksesshëm.

Me datën 26.04.2019 kemi kërkuar qasje ne dokumentet ne zyrën e prokurimit te Komunës së Klinës dhe pastaj me datën 30.04.2019 kemi pasur qasje ne dokumente lidhur me këtë aktivitet te prokurimit.

Gjatë qasjes ne dokumente ne kemi pare që operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë NNP "Arhiko.ing", kanë mungesë të disa dokumenteve (kërkesave) të cilat janë kërkuar dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë:

Shkelja 1
Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek neni 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar:

2.Një inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Infrastrukturë Rrugore me përvojë pune në projektin minimum 5 vite pas:

Dhe si dëshmi është kërkuar:
-Diplomat (e noterizuar origjinale);
-CV-të (origjinal+të nënshkruar nga vetë pala);
-Referenca në Hartim të projekteve;
-Kontrata valide pune tek operatori ekonomik si staf i rregulltë profesional ose para-kontrata e punës për projektin në fjalë për stafin profesional që nuk janë staf i operatorit ekonomik;

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë në listën e stafit, në lidhje me kërkesën për: Inxhinierin e diplomuar të Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Infrastrukturë Rrugore me përvojë pune minimum 5 vite, ka ofruar një inxhinier të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës – departamenti i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv. Ne listën e stafit të Operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë ky inxhinier është me nr.rendor 2(Ibrahim Selishta).

Pra, OE i rekomanduar për kontratë, nuk ka ofruar dëshmi se posedon inxhinier të Infrastrukturës Rrugore, ashtu siç është kërkuar në FDT, ndërsa sa për njoftim tuajin, iu sqarojmë se Inxhinieri i Infrastrukturës Rrugore i përket Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, ku në këtë fakultet është drejtimi (Infrastrukturë Rrugore). Këtë mund ta vërtetoni duke shikuar nëVeb-in e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës.

Për dallim nga OE i rekomanduar për kontratë, ne listën e stafit që e kemi prezantuar kemi inxhinier të Infrastrukturës Rrugore. Shiko listën e stafit dhe Diplomën që e kemi prezantuar ne Kompania Proing&PartnersShpk, ku mund ta vërtetoni këtë (Tek lista e stafit te prezantuar nga ana jonë me numrin rendor 2 është z.ShabanIdrizi).

Lidhur me kërkesën për Inxhinier të**Infrastrukturës Rrugore**, ju qartësojmë se kjo kërkesë ka qenë e qartë për të gjithë operatorët ekonomik, përderisa nuk ka ekzistuar asnjë kërkesë për informata shtesë sqaruese, e as ndonjë kërkesë për rishqyrtim apo ankesë në OSHP ndërsa në nenin 4.1 pika a) Te Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, Parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe Vlerat e tarifave të ankesave shkruan "Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të më poshtme:

"Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me **njoftimin e kontratës**ose me dokumentet e tenderit së paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave"

Sa për informim, drejtimet e fakulteteve mund ti vërtetoni nëVeb faqen e Universitetit të Prishtinës.

1.Fakulteti i Ndertimtarise dhe Arkitektures, konkretisht departamenti i ndërtimtarisë i ka katër programe studimore:
- Konstruktiv (BA dhe MA);
- Hidroteknikë (BA dhe MA);
- Gjeodezisë (BA) dhe
- Infrastrukturë rrugore (MA),

Duke u bazuar në kërkesën e AK-së dhe nëmospërmbushjen e kërkesës sëlartëcekur nga OE i rekomanduar për kontratë, rezulton se ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm dhe nuk mund të jetë fitues i kësaj kontrate.

Shkelja 2
Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek neni 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar:
10.Një agronom i diplomuar apo Kimist. Për agronomin apo Kimistin edhe licenca për Ndikim të Mjedisit (VNM). (Bachelor ose Master). Licenca duhet të jetë e noterizuar.

Dhe si dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar;

-Diplomat (e noterizuar origjinale);
-CV-të (origjinal+të nënshkruar nga vetë pala);
-Referenca në Hartim të projekteve;
-Kontrata valide pune tek operatori ekonomik si staf i rregulltë profesional ose para-kontrata e punës për projektin në fjalë për stafin profesional që nuk janë staf i operatorit ekonomik;

Duke u bazuar në kërkesat e larteshenuara, vërehet se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në listën e stafit, për agronomin apo kimistin me licencë për ndikim te mjedisit (VNM) ka ofruar një inxhiniere e cila është me profesion Profesor i Biologjisë (Biologe).

Pra, OE i rekomanduar për kontratë, nuk ka ofruar dëshmi se posedon Një agronom të diplomuar apo kimist, ashtu siç është kërkuar në FDT, por ka ofruar dëshmi për Biolog edhe pse është kërkuar decidivisht**Agronom** apo**Kimist. Biologu** i ofruar e ka dëshminë dhe licencën për ndikim te mjedisit (NVM), mirëpo nuk mbulohet kërkesa bazë (agronom apo kimist)sepse është kërkuar qartë agronom apo kimist, dhe duhet të ketë edhe licencën për Ndikim të Mjedisit (VNM).

Për dallim nga OE i rekomanduar, ne ne listën e stafit që e kemi prezantuar kemi një kimist. Shiko listën e stafit dhe Diplomën që e kemi prezantuar, ne kompania "Proing&Partners" shpk ku mund ta vërtetoni këtë (tek lista e stafit të prezantuar nga ana jonë me nr.rendor 10 është z.AdnanElshani).
Prandaj, OE i rekomanduar për kontratëështë i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar kërkesën e lartëcekur.
Lidhur me kërkesën për një**agronom i diplomuar apo kimist,** ju sqarojmë se kjo kërkesë ka qenë e qartë për të gjithë operatorët ekonomik, përderisa nuk ka ekistuar asnjë kërkesë për informata shtesë sqaruese, e as ndonjë kërkesë për rishqyrtim apo ankesë në OSHP, ndrërsa në nenin 4.1 pika a) Te Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, Parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe Vlerat e tarifave të ankesave shkruan "Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të më poshtme:

"Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me **Njoftimin e Kontratës** apo **Dokumentet e Tenderit,** së paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave".

Duke u bazuar në këto dëshmi, vërtetohet se OE i rekomanduar për kontratë, nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së, prandaj është dashur të shpallet si OE i papërgjegjshëm, konform nenit 59.4 të LPP-së, sepse aty shkruan qartë që: "Autoriteti Kontraktues do të konsideroj një tender si të përgjegjshëm, vetëm nëse tenderi në fjalëështë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Sa për informim, drejtimet e fakulteteve mund ti vërtetoni nëVeb faqen e Universitetit të Prishtinës.

1.Fakulteti i Ndertimtarise dhe Arkitektures, konkretisht departamenti i ndërtimtarisë i ka katër programe studimore:
- Konstruktiv (BA dhe MA);
- Hidroteknikë (BA dhe MA);
- Gjeodezisë (BA) dhe
- Infrastrukturë rrugore (MA),

Duke u bazuar në kërkesën e AK-së dhe nëmospërmbushjen e kërkesës sëlartëcekur nga OE i rekomanduar për kontratë, rezulton se ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm dhe nuk mund të jetë fitues i kësaj kontrate.

Shkelja 2
Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek neni 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar:
10.Një agronom i diplomuar apo Kimist. Për agronomin apo Kimistin edhe licenca për Ndikim të Mjedisit (VNM). (Bachelor ose Master). Licenca duhet të jetë e noterizuar.

Dhe si dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar;

-Diplomat (e noterizuar origjinale);
-CV-të (origjinal+të nënshkruar nga vetë pala);
-Referenca në Hartim të projekteve;
-Kontrata valide pune tek operatori ekonomik si staf i rregulltë profesional ose para-kontrata e punës për projektin në fjalë për stafin profesional që nuk janë staf i operatorit ekonomik;

Duke u bazuar në kërkesat e larteshenuara, vërehet se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në listën e stafit, për agronomin apo kimistin me licencë për ndikim te mjedisit (VNM) ka ofruar një inxhiniere e cila është me profesion Profesor i Biologjisë (Biologe).

Pra, OE i rekomanduar për kontratë, nuk ka ofruar dëshmi se posedon Një agronom të diplomuar apo kimist, ashtu siç është kërkuar në FDT, por ka ofruar dëshmi për Biolog edhe pse është kërkuar decidivisht**Agronom** apo**Kimist. Biologu** i ofruar e ka dëshminë dhe licencën për ndikim te mjedisit (NVM), mirëpo nuk mbulohet kërkesa bazë (agronom apo kimist)sepse është kërkuar qartë agronom apo kimist, dhe duhet të ketë edhe licencën për Ndikim të Mjedisit (VNM).

Për dallim nga OE i rekomanduar, ne ne listën e stafit që e kemi prezantuar kemi një kimist. Shiko listën e stafit dhe Diplomën që e kemi prezantuar, ne kompania "Proing&Partners" shpk ku mund ta vërtetoni këtë (tek lista e stafit të prezantuar nga ana jonë me nr.rendor 10 është z.AdnanElshani).
Prandaj, OE i rekomanduar për kontratëështë i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar kërkesën e lartëcekur.
Lidhur me kërkesën për një**agronom i diplomuar apo kimist,** ju sqarojmë se kjo kërkesë ka qenë e qartë për të gjithë operatorët ekonomik, përderisa nuk ka ekistuar asnjë kërkesë për informata shtesë sqaruese, e as ndonjë kërkesë për rishqyrtim apo ankesë në OSHP, ndrërsa në nenin 4.1 pika a) Te Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, Parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe Vlerat e tarifave të ankesave shkruan "Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të më poshtme:

"Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me **Njoftimin e Kontratës** apo **Dokumentet e Tenderit,** së paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave".

Duke u bazuar në këto dëshmi, vërtetohet se OE i rekomanduar për kontratë, nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së, prandaj është dashur të shpallet si OE i papërgjegjshëm, konform nenit 59.4 të LPP-së, sepse aty shkruan qartë që: "Autoriteti Kontraktues do të konsideroj një tender si të përgjegjshëm, vetëm nëse tenderi në fjalëështë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Shkelja 3
Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek neni 7.1 dhe 7.2 kërkesat e përshtatshmërisë profesionale është kërkuar:
Kërkesa 4: Certifikata për menaxhimin e sistemit të cilësisë – EN ISO 9001-2008 ose EN – ISO 9001-2015.
Kërkesa 5: Certifikata për sistemin e menaxhimit te mjedisit – EN ISO 14001-2015
Kërkesa 6: Certifikata për sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë EN ISO 18001-2015.
Dhe si dëshmi dokumentare është kërkuar:
Dëshmia 4: Kopje e noterizuar e certifikatës valide EN ISO 9001-2008 ose EN ISO 9001-2015
Dëshmia 5: Kopje e noterizuar e certifikatës valide EN ISO 14001-2015
Dëshmia 6: Kopje e noterizuar e certifikatës valide EN ISO 18001-2015

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, nuk ka paraqitur asnjërën nga këto certifikata, prandaj në mungesë të këtyre dëshmive ky OE është i papërgjegjshëm.

Shkelja 4
Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar sic duhet përshkrimin e çmimeve në formatin Excel, pasi që në formatin Excel e ka plotësuar çmimin e poentuar dhe nëse e shikojmë formatin Excel, nuk ka ndonjë kolonë ose hapësirë për tu vendosur çmimi i poentuar.

Ne si kompani kemi bërë pyetje shtesë para hapjes së ofertave lidhur me këtë çështje dhe në përgjigjen e dhënë nga AK na është konfirmuar që :

Paramasat në dosjen e tenderit dhe në përshkrimin e çmimeve në tabelën e çmimeve në Excel janë identike.
Ndryshim ka në atë se nëparamasë dhe përshkrimin e çmimeve në dosje janë të ndara të gjitha pozicionet në grupime për të dhënë çmimet në çdo pozicion vec e vec, që në fund të jetë çmimi në total i grupimit.
Derisa ne përshkrimin e çmimeve ne tabelën Excel është totali i vlerës së grupimit për tu vlerësuar me pikët e përcaktuara. Çdo grupim ka të përshkruar detyrat që janë për tu kryer si në Dosje ashtu edhe ne Çmimore, andaj çmimi i dal ne total te grupit vendoset në pozicionin total të grupit dhe rezultati do të vlerësohet për totalin e grupit, e në tërësi për pikët e fituara në totalin e tenderit.

Ne nëçmimore në platformë përshkrimi i çmimit në tabelë për të gjitha grupimet është Shënimi i Autoritetit Kontraktues: Ku është njoftuar teksti "Totali i Përgjithshëm i _____% për vlerësim. Totali me TVSH- €.

Siç shihet nga përgjigjja e dhënë nga AK-Klinë lidhur me kete çështje ku thotë: "Çmimi i dal në total të grupit vendoset ne pozicionin total te grupit", pra nëçmimoren e dhënë në formatin EXCEL ka vendosur çmimin e poentuar.

Kur merret parasysh ky fakt rezulton se ky OE ka bërë gabime aritmetikore më shumë se +-2%, dhe në këtë rast është shkelur NENI 41 i RRUOPP paragrafi 41.8 pika II ku thuhet:

ii. Ne rast se shuma e korrigjuar është më shumë se +/-2%, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur formën standarde B42.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë rezulton se formulari i tenderit nuk është plotësuar siç duhet, ndërsa sipas: Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik (RRUOPP) në nenin 39 Sqarimi i Tenderit paragrafi 39.8 përshkruhet dhe përcaktohet qartë:

Formulari i tenderit nuk është plotësuar siç duhet – Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

ANKESA PER GRUPIN E OPERATOREVE EKONOMIK N.T.SH. "Infratek"; "A2 Enginiering" SH.P.K

SHKELJA 1
Grupi i Operatorëve ekonomik N.T.SH. "Infratek& A2 Enginiering" SHPK nuk e kanë plotësuar përshkrimin e çmimeve që ndodhet në dosjen e tenderit, pra *mungon*kjo pjesë dhe nuk është ngarkuar në platformën elektronike. Me këtë fakt rezulton se ky operator ekonomik nuk ka ofruar fare çmim, sepse tek rubrikat çmimet për njësi nuk i ka plotësuar fare rubrikat, prandaj për këtë arsye konsiderohet i papërgjegjshëm, sepse nuk e ka plotësuar pjesën kryesore të dosjes së tenderit, pra Formulari C-pjesa

e çmimeve>Ndërsa në nenin 28.14 të RRUOPP shkruan "Funksioni i vetëm i peshimit te çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmim më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet sipas çmimit të ofertuar. Çmimi total i poentuar (peshuar) lexohet gjatë procesit të hapjes së ofertave. Në këtë rast nuk është ofruar çmim për pozicione-për njësi, kurse në këtë tender nuk dihet numri i sasive të sakta, ndërsa nëse supozojmë se fituesi i kontratës do të jetë ky operator ekonomik, atëherë shtrohet pyetja si ka mundësi të bëhet pagesa p.sh. nëse kryhen shtatë shërbime në pozicionin katër, kurse 20 sherbime në pozicionin dy (pa u ditur çmimi për njësi)?.

Ky grup i operatoreve e ka ngarkuar vetëm formatin e EXCELIT, gjë qëështë e papranueshme sepse në formatin e EXCELIT janë vetëm pozicionet e grupimeve totale, pra së pari është dashur të plotësohet përshkrimi i çmimeve në dosjen e tenderit, pra është dashur të jepen Çmimet në çdo pozicion veç e veç, që në fund të jetë çmimi në total i Grupimit, dhe pastaj ky çmim total është dashur të vendoset në formatin EXCEL.

Po ashtu pa plotësimin e përshkrimit të çmimeve në dosjen e tenderit nuk është e mundur të vendoset çmimi total i grupimit në formatin EXCEL, pa u vendosur çmimi nëpër pozicione, pra për njësi, kur dihet se çmimi për njësi mbizotëron dhe shërbimi duhet të kryhet me çmimin e ofruar për njësi.

Duke u bazuar në këtë dëshmi rezulton se ky grup i operatorëve ekonomik nuk ka ofruar çmim fare, duke mos u plotësuar formulari i tenderit siç duhet, ndërsa Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP) në nenin 39 Sqarimi i tenderit paragrafi 39.8 përshkruan në këtë mënyrë:
Formulari i tenderit nuk është plotësuar siç duhet – Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Poashtu nëse e shikojmë formatin EXCEL të përshkrimit të çmimeve të plotësuara nga ky grup i operatorëve ekonomik nëse e mbledhim gjitha grupimet si total del oferta prej 1.88 Euro dhe kësaj vlere nuk i është shtuar TVSH, pra TVSH në formularin e ofertës është 0.00 Euro, gjë qëështë kundërligjore oferta pa TVSH. Nëse i shtohet edhe vlera e TVSH kësaj oferte del të jetë 1.88 *18%= 2.22 Euro dhe në këtë rast shihet që ky grup i operatorëve ekonomik ka bërë gabime aritmetike gjatë llogaritjes së ofertës më shumë se +-2%.

Kur merret parasysh ky fakt rezulton se ky OE ka bërë gabime aritmetikore më shumë se +-2%, dhe në këtë rast është shkelur Neni i 41 i RRUOPP paragrafi 41.8 pika II ku thuhet:

ii. Ne rast se shuma e korrigjuar është më shumë se +/-2%, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B42.

ANKESA PËR GRUPIN E OPERATORËVE EKONOMIK N.N.SH. Vizion Projekt & NP. ART PROJECT

SHKELJA 1
Grupi i Operatorëve ekonomik NNSH Vizion Project & NP ART PROJECT nuk e kanë plotësuar përshkrimin e çmimeve që ndodhet në dosjen e tenderit, pra ***mungon*** kjo pjesë dhe nuk është ngarkuar në platformën elektronike, prandaj njëjtë si operatori ekonomik i lartëcekur NTSH Infratek&A2 Enginiering SHPK ky operator ekonomik nuk e ka plotësuar formularin e tenderit, prandaj kjo ofertëkonsiderohet e papërgjegjshme.

Me këtë fakt rezulton se ky operator ekonomik nuk ka ofruar fare çmim, sepse tek rubrikat çmimet për njësi nuk i ka plotësuar fare rubrikat, prandaj për këtë arsye konsiderohet i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar pjesën kryesore të dosjes së tenderit, pra formularin C – pjesa e çmimeve. Ndërsa në nenin 28.14 tëRrUOPP shkruan: "Furnksioniivetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmim më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet në bazë të çmimit të ofertuar. Çmimi total i poentuar (peshuar) lexohet gjatë procesit të hapjes së ofertave. Në këtë rast nuk është ofruar çmim për pozicione - për njësi, kurse në këtë tender nuk dihet numri i sasive të sakta, ndërsa nëse supozojmë se se fituesi i kontratës do të jetë ky operator, atëherë shtrohet pyetja si ka mundësi të bëhet pagesa p.sh. nëse kryhen shtatë (7) shërbime në pozicionin katër (4), kurse 20 shërbime në pozicionin dy (2) (pa u ditur çmimi për njësi)?

Ky grup i operatorëve e ka ngarkuar vetëm formatin e EXCELIT gjë qëështë e papranueshme sepse në formatin e EXCELIT janë vetëm pozicionet e grupimeve totale, pra së pari është dashur të plotësohet përshkrimi i çmimeve në dosjen e tenderit, pra është dashur të jepet çmimi në çdo pozicion veç e veç, që në fund të jetë çmimi total i grupimit dhe pastaj ky çmim total është dashur të vendoset në formatin EXCEL.

Po ashtu pa plotësimin e përshkrimit të çmimeve në dosjen e tenderit nuk është e mundur tëvendoset çmimi total i grupimit në formatin EXCEL, pa u vendosur çmimi nëpër pozicione, pra për njësi, kur dihet se sipas nenit 59.3 të LPP-së, çmimi për njësi mbizotëron dhe shërbimi duhet të kryhet me çmimin e ofruar për njësi.

Duke u bazuar në këtë dëshmi rezulton se ky grup i operatorëve ekonomik nuk ka ofruar çmim fare, duke mos u plotësuar formulari i tenderit siç duhet, ndërsa Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik (RrUOPP) në nenin 39 Sqarimi i Tenderit paragrafi 39.8 përshkruan dhe përcakton qartë:

Formulari i tenderit nuk është plotësuar siç duhet – Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

SHKELJA 2

Marrëveshja e konzorciumitështë shumë e mangët me një faqe dhe nuk e përmbush kërkesën e AK-së për formimin e konzorciumit.

SHKELJA 3
Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek neni 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar:

2.Një inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Infrastrukturë Rrugore me përvojë pune në projektin minimum 5 vite pas:

Dhe si dëshmi është kërkuar:
-Diplomat (e noterizuar origjinale);
-CV-të (origjinal+të nënshkruar nga vetë pala);
-Referenca në Hartim të projekteve;
-Kontrata valide pune tek operatori ekonomik si staf i rregulltë profesional ose para-kontrata e punës për projektin në fjalë për stafin profesional që nuk janë staf i operatorit ekonomik;

Duke u bazuar në kërkesat e lartëshënuara, grupi i Operatorëve ekonomik NNSH Vizion Project & NNP ART PROJECT në listën e stafit, për kërkesën në lidhje me : Inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Infrastrukturë Rrugore me përvoj pune min.5 vite, ka ofruar një Inxhinier të Universitetit Politeknik të Tiranës – Fakulteti i Inxhinierisë së ndërtimit drejtimi transport, e që ky inxhinier nuk është Inxhinier i drejtimit Infrastrukturë Rrugore ashtu siç është kërkuar në FDT. Në listën e stafit të grupit të operatorëve ekonomik ky inxhinier është me nr.rendor 2 (DenisJano).

SHKELJA 4

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek neni 9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar:

Kërkesa 2 – Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, Hartim projekteve (rruge, ujësjelles, kanalizim, matje gjeodezike, parqe, kanale të ujitjes, hapsira gjelbëruese, objekte shkollore-administrative-kulturore, salla sportive etj), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min.180,000.00 €.

Dhe si Deshmiështë kërkuar:

Deshmia 2 – Lista e kontratave origjinal e nënshkruar dhe vulosur. Për cdo projekt, të bëhet përshkrimi me këto informata titullin e kontratës, autoritetin kontraktues, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës dhe rolin e operatorit ekonomik në zbatimin e kontratës (lider apo partner). Referencat apo certifikatat për kryerjen e punëve, kopje e prezantuara në listën e kontratave.
Nëse shohim listën e kontratave te prezantuara nga ana e Liderit te konzorciumit NNSH Vizion Project, shihet qe nuk e ka bere ne formën sic e ka kërkuar AK, dhe si e tille nuk mund te merret parasysh nga AK.

Nëse shohim listën e kontratave te prezantuara nga ana e anëtarit tjetër tëkonzorciumit NP ART PROJECT shihet që shuma e

kontratave është në vlerën 124,841.14 Euro dhe nuk e plotëson kërkesën e specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës, ku është kërkuar që vlera minimale e projekteve te jete min.180,000.00 Euro.

Në vendimin e AK-së të datës 07.05.2019 për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim Autoriteti Kontraktues e ka pranuar faktikisht që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi për inxhinierin e ndërtimtarisë së Infrastrukturës rrugore dhe nuk ka ofruar dëshmi për agronom apo kimist, por i ka marr për bazëlëmitë dhe drejtimet tjera në mënyrë të kundërligjore dhe në kundërshtim me kërkesat e FDT-së.

Njëkohësishtë për pretendimin tonë lidhur me mungesën e ISO standardeve të OE te rekomanduar per kontrate, vetëm e kane shënuar se i kane dhe ne asnjë menyre nuk kane arritur të Dëshmojnë se ka ISO certifikata.

Edhe pretendimet tona tjera, autoriteti kontraktues në vendimin e lartepermdnur i ka refuzuar pa ofruar ndonjë dëshmi apo prove konkrete.

Ndërsa pretendimet tona për të dy operatoret ekonomik tjerë NTSH. Infratek&A2 Enginiering SHPK dhe NNSH. Vizion Project &ART PROJECT, se nuk i kane plotësuar përshkrimin e çmimeveqe ndodhen ne dosjen e tenderit, autoriteti kontraktues i ka pranuar si te qëndrueshme, prandaj rezulton se edhe per OE e rekomanduar per kontrate edhe per dy operatoret e tjerë faktikisht, autoriteti kontraktues e ka pranuar se nuk i plotësojnë te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate. Poashtu nuk eshte bere poentomi sipas Nenit 30.1 te FDT-se. Poashtueshte shkelur edhe neni 41i RRUOPP.

Gjithashtu janë shpallur të përgjegjshëm edhe dy operatorët ekonomik tjerë NTSH. Infratek&A2 Enginiering SHPK dhe NNSH. Vizion Project &ART PROJECTte cilët faktikisht nuk i kane plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, ashtu siç janë kërkuar dhe siç parashihet në nenin 64 të LPP-së, përkitazi me nenin 69 të LPP-së, prandaj edhe në këtë rast nuk është respektuar neni 59.4 i LPP-së.

Me këtë rast ne jemi diskriminuar, ndërsa është favorizuar OE i rekomanduar për kontratë në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Në fund kërkojmë nga Organi Shqyrtues i prokurimit që të nxjerr:

VENDIM
APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "Proing&Partners" SHPK
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për Dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në RIVLERESIM, dhe gjate rivlerësimit, ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave të bëhet sipas dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, në të kundërtën, ne jemi detyruar të vazhdojmë me procedurat ligjore në instancat tjera vendimmarëse.

Demet materiale
Demet materiale janë te gjitha shpenzimet qe janë bere per te ofertuar dhe tani me parashtrimi i kërkesave per rishqyrtim, ankesave etj, ne vlerën 5,000 euro.

Kërkesa për Rishqyrtim 02.05.2019
Përgjigje nga AK: Kërkesa për rishqyrtim 07.05.2019

Konstatim përfundimtar edhe ne VENDIMIN e AK te datës 07.05.2019 te Refuzimit të kerkesesper rishqyrtim ka dhenekete përgjigje:
OE i propozuar "Arhiko.Ing" lidhur me pretendimin nr.1 per Inxhinier te infrastrukturës rrugore , por inxhinieri ka profilin Inxhinier i Ndertimtarise, ku ka përfunduar fakultetin atëherë kur kete lëmi e kishte, pra e ka përmbushur kriterin e AK-së.

Pretendimi nr.2 lidhur me Kerkesenper Agronom te diplomuar apo kimist me licence per VNM, AK ka pranuar inxhinier te bujqësisë me qe ka licence per VNM.
Te pretendimi nr.3 lidhur me ISO standardet
OE i propozuar per kontrate ka standardet e kërkuara.

Pretendimi nr.rendor 4 Gabimet ne llogaritje, me qe çmimet ne paramasa pozicion janë çmime qe ju janë marr per baze derisa OE ka dhene ne Cmimoren ne Excel çmimet e peshuara, gje qe nuk eshte Gabim ne llogaritje.

Krejt kjo eshte bere duke llogaritur Ekonomicitetin dhe Qellimin, nenin 1 dhe 6.

Derisa per shkeljet per OE te renditura ne renditjen sipas peshave te pozicioneve per Grupin e OE. INFRATEK & A2 Engeniering SHPK, shkelja e pretenduar se nuk ka dhene pozicionet nuk i ka te dhëna per pozicione andaj konstatimi qëndron.

Dhe pretendimi per G.O.E "Vizion Projekt" & "ART Projekt", nuk kane plotësuar cmimoren ne dosjen e tenderit, Qendron.

Nisur nga te gjitha këto qe u thane AK duke u bazuar ne nenin 1 te LPP-se Qellimi me ofertën e propozuar per shpërblim me kontrate do te ja arrij qëllimit qe te kemi shërbime te nevojshme me kosto me te ulet, bazuar ne ate neni 6 Ekonomiciteti bazuar ne ate se Oferta e OE te propozuar per shpërblim te kontratës ka çmimin total per te gjitha pozicionet prej 2.29 €, derisa oferta juaj eshte (Proing&Partners) 5.76 euro apo me e larte per 3.47 € apo 60.02%, qe Nese shikojmë planifikimin e projektimeve qe do te realizohen nga AK janë shifra qe do te dëmtohet buxheti ne menyre drastike, derisa OE i propozuar per shpërblim me kontrate ka pranuar çmimet e ofruara dhe ka dhene zotimin qe projektet do ti kryej ne menyre profesionale me qe nga Referencat e tija jemi te bindur.

KRITERET E KËRKUARA:

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1 Deklaratë nën betim – Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbipërshtatshmërinë në pajtim me Ligjin mbi ProkuriminPublik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publiktë Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dheligjin Nr. 05 L-092 Ligjin Nr. 04 L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.	**Dëshmia 1 Deklarata nën betim – e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes).**
	Dëshmia 2 Vërtetimi i ATK (i verifikuar ne web faqen e ATK-se).
	Dëshmia 3 Vërtetimi nga gjykata kompetente (Origjinal ose kopje e noterizuar nga noteri).
Kërkesa 2 Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore, se ju nuk keni obligime borxhe te tatimeve në ATK. Vlefshmëria e vërtetimit duhet te jete maksimumi 90 dite nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes se ofertave. Vërtetimi kërkohet origjinal ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës.	**Deshmia 4.Vertetimi nga Komuna qe nuk ka obligime te pashlyera ndaj komunessiqjane tatimi ne prone , taksa , qera apo obligime tjera .** **Vertetimi duhet te jete ne origjinal me validitet jo me i vjeter se 90 diite dhe i leshuar nga komuna ku operatori ka seline dhe veprimtarine .**
Kërkesa 3 Dëshmi se kompania (biznesi) nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësorë te lëshuar nga Gjykata kompetente. Vërtetimi kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 90 dite nga data e lëshimit	**Kerkohetvetemper te propozuarin perdhenje te kontrates para vendimit pershperblim me kontrate • Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle Vertetimi ne piken, 2, 3, DHE 4 jep te drejte Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj si të papërgjegjshme ta bëjë konfiskimin e sigurimit të tenderit dhe te**

deri ne ditën e dhënies. Kerkesa 4. Vertetimi nga Komuna qe nuk ka obligime te pashlyera ndaj komunessiqjane tatimi ne prone , taksa , qera apo obligime tjera . Vertetimi duhet te jete ne origjinal me validitet jo me i vjeter se 90 diite dhe i leshuar nga komuna ku operatori ka seline dhe veprimtarine . Kerkohetvetemper te propozuarin perdhenje te kontrates para vendimit pershperblim me kontrate .	vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe
Përshtatshmëria profesionale: Kërkesa 1 Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin professional, komercial dhe ose regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Dëshmia 1 Certifikatën e regjistrimit te Biznesit – se bashku me informatat për biznesin, te lëshuar nga Autoritetet e Regjistrimit te Biznesit(si veprimtari ta kete te regjistruar projektimin) – Kopje.
Kërkesa 2 Regjistrimi i Numrit Fiskal.	Dëshmia 2 Certifikatën e Numrit Fiskal – Kopje
Kërkesa 3 Regjistrimi i TVSH – së	Dëshmia 3 Certifikatën e TVSH – Kopje.
Kërkesa 4 Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN – ISO 9001 2008 ose EN – ISO 9001 2015.	Dëshmia 4 Kopje e noterizuar e certifikatës valide EN – ISO 9001 2008 ose EN – ISO 9001 2015.
Kërkesa 5 Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit EN – ISO 14001 2015.	Dëshmia 5 Kopje e noterizuar e certifikatës valide EN – ISO 14001 2015.
Kërkesa 6 Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë EN – ISO 18001 - 2015	Dëshmia 6 Kopje e noterizuar e certifikatës valide EN – ISO 18001 - 2015.
Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve te fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë jo më pak se 240,000.00 €. INFORMATË SHTESË NË RAST TË KONZERCIUMIT-LIDERI DUHET TE PLOTESOJ MIN.60% TË KERKESAVE -EKONOMIKE @FINANCIARE,	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Dëshmia 1 Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. INFORMATË SHTESË NË RAST TË KONZERCIUMIT-LIDERI DUHET TE PLOTESOJ MIN.60% TË KERKESAVE - EKONOMIKE @FINANCIARE,
Kapaciteti teknik dhe professional: Kërkesa 1 Stafi profesional 1. Një projekt menaxher (inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – drejtimi Konstruktiv) me përvojë pune ne projektim minimumi 5 vite pas diplomimit; 2. Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose master -	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* Dëshmia 1 Lista e stafit profesioanl te paraqitet origjinal e nenshkruar dhe e vulosur. Per stafin profesioanl duhet te prezentohen • Diplomat (e noterizuar origjinale); • Cv-të (origjinal + të nënshkruar nga vetë pala); •

Drejtimi Infrastrukture Rrugore - me përvojë pune ne projektim minimumi 5 vite pas 3. Një Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës ose master - me përvojë pune ne projektim minimumi 5 vite pas diplomimit; 4. Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose master - Drejtimi Hidroteknike - me përvojë pune ne projektim minimumi 5 vite pas diplomimit; 5. Një Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Elektroteknike ose master - me përvojë pune ne projektim minimumi 5 vite pas diplomimit; 6. Një Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Makinerike ose master – me përvojë pune ne projektim minimumi 5 vite pas diplomimit; 7. Një vlersues te pasurive te paluejsheme me license "Vlersesues i shkalles se pare". 8. Një Inxhinier i Gjeodezisë ose master me përvoje pune profesionale minimum 5 vite pas diplomimit; 9. Një Inxhinier i gjeologjisë ose master me përvojë pune profesionale minimumi 5 vite pas diplomimit; 10. Një agronom i diplomuar apo kimist. Per agronomin apo kimistin edhe licensaper Ndikim te mjedisit (VNM). (Bachelor ose master). Licenca duhet te jete e noterizuar. ;	Referenca ne hartim te projekteve • Kontrata valide pune tek operatori ekonomik si staf i rregullt profesional ose Para-kontrata e punës per projektin ne fjale për stafin prefesional qe nuk jane staf i operatorit ekonomik ; • Nje deklarate me shkrim per caktimin e menaxherit te projektit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 1.
Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, Hartim i projekteve (Rruge, ujësjellës, kanalizim, matje gjeodezike, parqe, kanale te ujitjes, hapësira gjelbëruese, objekte shkollore-administrative-kulturore, salla sportive etj.), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 180,000.00 €. Kërkesa 3 . Operatori ekonomik duhet te ketepaisjet dhe stabilimente e nevojeshmeper hartim te projekteve siq janë obligative GPS , Dron , dhe paisje tjera te domosdoshme .	Dëshmia 2 Lista e kontratave origjinal e nenshkruar dhe vulosur. Percdo projekt, te behet pershkrimi me keto informata titullin e kontrates, autoritetin kontraktues, daten e fillimit te kontrates, daten e perfundimit te kontrates, vleren e kontrates dhe rolin e operatorit ekonmik ne zbatimin e kontrates (lider apo partner). Referencat apo certifikatat per kryerjen e puneve, kopje per kontratat e prezentuara ne Listen e kontratave. Dëshmia 3 Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe paisjeve- origjinal e nenshkruar dhe vulosur, per GPS dhe Drone-te posedoj deshmi te pronesise apo marrveshje te shfrytezimit nga ndonje kompani. INFORMATË SHTESË NË RAST TË KONZERCIUMIT-LIDERI DUHET TE PLOTESOJ MIN.60% TË KERKESAVE - TEKNIKE@PROFESIONALE,

A. **një deklaratë e qartë** ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës
B. **një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët**, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;
C. **një deklaratë të nënshkruar** nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe
D. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të **jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.

E. **Operatoret ekonomik janë te obliguar qe regjistrohen ne platformën e E-prokurimit ne adresën: ëëë.e-prokurimi.rks-gov.net**

F. **OE janë te obliguar qe dosjen ne emrin e vet ta tërheqin nga kjo platformë.**

a) **një deklaratë** ku deklarojnë nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatëse të prokurimit, dhe

b) Të gjithë nenkontraktorët do të **jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.

Tenderuesi duhet të depozitoj sigurimin e tenderit.

Shuma e Sigurimit të Tenderit është:2,000.00€ për kohëzgjatje 120 dite.

Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është (12 000 Euro) për kohëzgjatjen prej 37 muajsh.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 25.02.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....Furnizime,Vlera e madhe,
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave:.....20.03.2019
Data e hapjes së ofertave:.....20.03.2019
Kërkesa per rishqyrtim : 02.05.2019
Lloji i kontratës: .....kontrate kornize 36 muaj
Vlera e parashikuar .....120,000.00 €
Kriteri për dhënie të kontratës.....tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

1.Përgjigje e AK-së për kërkesën për rishqyrtim

- **VENDIM I REFUZIMIT – datë 07.05.2019**

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €	Vërejtje
1.	Proing&Partners SHPK	Prishtinë	5.76 €	Jo
2.	Grupi i OE Infratek&A2 Enginiering	Lipjan	1.88 €	Jo
3.	NNP. Arhiko.ing	Prishtine	0.65 €	Jo
4.	Grupi i OE Vizion Project & Art Project	Prishtinë	2.29 €	Jo

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit ri-vlerësues.
Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Visar Bojaj– Kryetar i komisionit
- Dardan Bashota– Anëtar i komisionit
- Isa Gashi– Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Deklaratë e Komisionit

Komisioni i vlerësimi ka shpallur fitues "ARHIKO.ING" nga Prishtina me çmim 1.96 € / 72.74 pikë.

Konstatimet e ekspertit ankesa Nr.212/19 (OE. "Proing&Partners)

Sqarimi 1

Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapursherbim, me vlerë të madhe, **kontratë për Sherbime për 36 muaj**, dhe kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Vlera e parashikuar per tri (3) vite eshte 120,000.00 €.

Pretendimi i parë ankimor i OE ankues

OE ankues pretendon se: Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek neni 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar:
Një inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Infrastrukturë Rrugore me përvojë pune në projektin minimum 5 vite pas:
Dhe si dëshmi është kërkuar:
-Diplomat (e noterizuar origjinale);
-CV-të (origjinal+të nënshkruar nga vetë pala);
-Referenca në Hartim të projekteve;
-Kontrata valide pune tek operatori ekonomik si staf i rregulltë profesional ose para-kontrata e punës për projektin në fjalë për stafin profesional që nuk janë staf i operatorit ekonomik;

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë në listën e stafit, në lidhje me kërkesën për: Inxhinierin e diplomuar të Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Infrastrukturë Rrugore me përvojë pune minimum 5 vite, ka ofruar një inxhinier të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës – departamenti i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv. Ne listën e stafit të Operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë ky inxhinier është me nr.rendor 2(Ibrahim Selishta).

Pra, OE i rekomanduar për kontratë, nuk ka ofruar dëshmi se posedon inxhinier të Infrastrukturës Rrugore, ashtu siç është kërkuar në FDT, ndërsa sa për njoftim tuajin, iu sqarojmë se Inxhinieri i Infrastrukturës Rrugore i përket Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, ku në këtë fakultet është drejtimi (Infrastrukturë Rrugore). Këtë mund ta vërtetoni duke shikuar në Veb-in e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës.

Eksperti i OSHP-së sqaronse OE ankues nuk e ka në listën e stafit sipas kriterit të kërkuar "Një inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Infrastrukturë Rrugore me përvojë pune në projektin minimum 5 vite***", por ka inxhinier të ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv (Ibrahim Selishta).***
Pra, kërkesa e AK-së nuk përmbushet siç është kërkuar ne FDT.

Pra, në këtë pikë nuk e plotëson këtë kriter OE i rekomanduar.

Pretendimi i dyte ankimor i OE ankues

OE ankues pretendon se: "Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek neni 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar:
Një agronom i diplomuar apo Kimist. Për agronomin apo Kimistin edhe licenca për Ndikim të Mjedisit (VNM). (Bachelor ose Master). Licenca duhet të jetë e noterizuar;
Dhe si dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar;
-Diplomat (e noterizuar origjinale);
-CV-të (origjinal+të nënshkruar nga vetë pala);
-Referenca në Hartim të projekteve;
-Kontrata valide pune tek operatori ekonomik si staf i rregulltë profesional ose para-kontrata e punës për projektin në fjalë për stafin profesional që nuk janë staf i operatorit ekonomik;

Eksperti i OSHP-së sqaron se:OE ankues lidhur me kete kriter ne dosjen e OE se propozuar gjindet : Luljeta Ajdini e cila me profesion eshtebiologe, por eshte e licencuar per NVM, pra kriteri i kërkuar i AK ka qene agronom apo Kimist, por OE i rekomanduar ne stafin e tij e ka me profesion (profesor i Biologjise – Luljeta Ajdini).

Pretendimi i OE në lidhje me diplomën është i bazuar, pasi qe nuk e përmbush kriterin qe te jete Kimist apo agronom, por kandidatja eshte e licencuar nga Ministria e Mjedisit te Kosovesper NVM.

Pretendimi i tretë ankimor i OE ankues

Pretendimi i OE ankues se:
Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek neni 7.1 dhe 7.2 kërkesat e përshtatshmërisë profesionale është kërkuar:

Kërkesa 4: Certifikata për menaxhimin e sistemit të cilësisë – EN ISO 9001-2008 ose EN – ISO 9001-2015.
Kërkesa 5: Certifikata për sistemin e menaxhimit te mjedisit – EN ISO 14001-2015
Kërkesa 6: Certifikata për sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë EN ISO 18001-2015.
Dhe si dëshmi dokumentare është kërkuar:
Dëshmia 4: Kopje e noterizuar e certifikatës valide EN ISO 9001-2008 ose EN ISO 9001-2015
Dëshmia 5: Kopje e noterizuar e certifikatës valide EN ISO 14001-2015
Dëshmia 6: Kopje e noterizuar e certifikatës valide EN ISO 18001-2015

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, nuk ka paraqitur asnjërën nga këto certifikata, prandaj në mungesë të këtyre dëshmive ky OE është i papërgjegjshëm.

Eksperti i OSHP-së sqaron se ne dosjen e tenderit te OE se propozuar per kontrate gjendet nje dokument CERTIFICATE e lëshuar nga **AQRA** Serbi, me mbishkrim PASS 99:2012, ku në këtë certifikatë në përshkrim thuhet se ARHIKO.ING ka ISO 9001:2015; ISO 14001:2015, OHSAS 18001:2007.
Dokumenti është lëshuar me datë 21.09.2018 dhe skadon me datë 20.09.2019, ku Certifikata ka nr. SR.90.032.
Dokumenti është i noterizuar me datë 04/10/2018 te Noter Agron L.Vrenezi.

Pra, bazuar në kërkesën e AK-së dy kriteret e kërkuara 9001:2015 dhe 14001:2015 i plotëson, mirëpo te ISO për shëndet në punë dhe siguri, OE e ka sjellur 18001:2007, pasi që kërkesa e AK-sëështë 18001:2015.
Të gjithë OE ofertues të cilët i kanë këto certifikata janë me nr.të tillë, pra ISO 18001:2007.

Pretendimi i pabazuar

Pretendimi i katërt ankimor i OE ankues

OE ankues pretendon se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar sic duhet përshkrimin e çmimeve në formatin Excel, pasi që në formatin Excel e ka plotësuar çmimin e poentuar dhe nëse e shikojmë formatin Excel, nuk ka ndonjë kolonë ose hapësirë për tu vendosur çmimi i poentuar.

Ne si kompani kemi bërë pyetje shtesë para hapjes së ofertave lidhur me këtë çështje dhe në përgjigjen e dhënë nga AK na është konfirmuar që :

Paramasat në dosjen e tenderit dhe në përshkrimin e çmimeve në tabelën e çmimeve në Excel janë identike.

Ndryshim ka në atë se nëparamasë dhe përshkrimin e çmimeve në dosje janë të ndara të gjitha pozicionet në grupime për të dhënë çmimet në çdo pozicion vec e vec, që në fund të jetë çmimi në total i grupimit.

Derisa ne përshkrimin e çmimeve ne tabelën Excel është totali i vlerës së grupimit për tu vlerësuar me pikët e përcaktuara.

Çdo grupim ka të përshkruar detyrat që janë për tu kryer si në Dosje ashtu edhe ne Çmimore, andaj çmimi i dal ne total te grupit vendoset në pozicionin total të grupit dhe rezultati do të vlerësohet për totalin e grupit, e në tërësi për pikët e fituara në totalin e tenderit.

Ne në çmimore në platformë përshkrimi i çmimit në tabelë për të gjitha grupimet është Shënimi i Autoritetit Kontraktues: Ku është njoftuar teksti "Totali i Përgjithshëm i _____% për vlerësim. Totali me TVSH- €.

Siç shihet nga përgjigjja e dhënë nga AK-Klinë lidhur me kete çështje ku thotë: "Çmimi i dal në total të grupit vendoset ne pozicionin total te grupit", pra në çmimoren e dhënë në formatin EXCEL ka vendosur çmimin e poentuar.

Kur merret parasysh ky fakt rezulton se ky OE ka bërë gabime aritmetikore më shumë se +-2%, dhe në këtë rast është shkelur NENI 41 i RRUOPP paragrafi 41.8 pika II ku thuhet:

ii. Ne rast se shuma e korrigjuar është më shumë se +/-2%, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur formën standarde B42.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë rezulton se formulari i tenderit nuk është plotësuar siç duhet, ndërsa sipas: Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik (RRUOPP) në nenin 39 Sqarimi i Tenderit paragrafi 39.8 përshkruhet dhe përcaktohet qartë:

Formulari i tenderit nuk është plotësuar siç duhet – Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Eksperti i OSHP-së sqaron se OE i rekomanduar për kontratë në platformën e prokurimit e ka vendosur çmimin e poentuar të ofertës 0.631 €, edhe ne përshkrimin e çmimeve te FDT-së OE "Arhiko.ing" e ka vendosur çmimin për njësi, ku çmimi i poentuar eshte 0.631 €.
Pra, nëse marrim dhe i krahasojmë çmimin njësi që OE ankues e ka bashkangjitur në platformë te Pjesa II-Përshkrimi i çmimeve nuk përputhet me Formularin C, sepse në formularin C - OE i propozuar ka shënuar 0.631 €, por nëse e marrim paramasën te totali i paramasës duhet të jetë 1.98 €, kurse OE e ka vendosur çmimin e peshuar 0.631 €, kurse vlera e TVSH-se ne formularin e bashkangjitur ne EXCEL te OE. "Arhiko.ing"te propozuar eshte ne katër (4) pozicione (poz.1,2,3,5) totali i TVSH-së është 0.00 €, kurse me nje pozicion (poz.nr.4) është 0.09 € por duhet te jete 0.35 € (vlera e TVSH-së).
Pra, perputhet çmimi i poentuar ne Formularin e Tenderit dhe në Pershkrimin e çmimit, por nuk perputhet me formatin EXCEL.
Ne tabelën e formatit EXCEL duhet te vendoset totali i pjeses 1, pjeses.2, pjeses 3, pjeses 4 dhe pjeses.5. kurse OE i propozuar ka vendosur çmimin njësi e jo totalin e pjesës 1, 2,3, 4 dhe 5.
Pra, nuk eshte plotësuar siç duhet tabelari ne formatin EXCEL.

Pra, bazuar ne këto sqarime qe i paraqita me lartë rezulton se nuk ka përputhje të ofertës me formularin C, dhe tabelës se EXCELIT (qe duhet te jete Totali i vlerës i paraqitur ne kete tabele), dhe bazuar në nenin 39.8 të RrUOPPdallimi tejkalon vlerën e lejuar +/-2%.

Pra, bazuar ne pretendimin ankimor te OE ankues mendojmë se OE "Arhiko.ing" i propozuar per kontrate nuk e ka plotësuar sic duhet tabelarin ne EXCEL te bashkangjitur ne dosje

Pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

ANKESA PËR GRUPIN E OPERATORËVE NTSH. "Infratek" & "A2 Enginiering"

<u>Pretendimi i parëankimor i OE ankues për grupin e operatorëve</u>
Grupi i Operatorëve ekonomik N.T.SH. "Infratek& A2 Enginiering" SHPK nuk e kanë plotësuar përshkrimin e çmimeve që ndodhet në dosjen e tenderit, pra *mungon*kjo pjesë dhe nuk është ngarkuar në platformën elektronike. Me këtë fakt rezulton se ky operator ekonomik nuk ka ofruar fare çmim, sepse tek rubrikat çmimet për njësi nuk i ka plotësuar fare rubrikat, prandaj për këtë arsye konsiderohet i papërgjegjshëm, sepse nuk e ka plotësuar pjesën kryesore të dosjes së tenderit, pra Formulari C-pjesa e çmimeve>Ndërsa në nenin 28.14 të RRUOPP shkruan "Funksioni i vetëm i peshimit te çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmim më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet sipas çmimit të ofertuar. Çmimi total i poentuar (peshuar) lexohet gjatë procesit të hapjes së ofertave. Në këtë rast nuk është ofruar çmim për pozicione-për njësi, kurse në këtë tender nuk dihet numri i sasive të sakta, ndërsa nëse supozojmë se fituesi i kontratës do të jetë ky operator ekonomik, atëherë shtrohet pyetja si

ka mundësi të bëhet pagesa p.sh. nëse kryhen shtatë shërbime në pozicionin katër, kurse 20 sherbime në pozicionin dy (pa u ditur çmimi për njësi)?.

Ky grup i operatoreve e ka ngarkuar vetëm formatin e EXCELIT, gjë që është e papranueshme sepse në formatin e EXCELIT janë vetëm pozicionet e grupimeve totale, pra së pari është dashur të plotësohet përshkrimi i çmimeve në dosjen e tenderit, pra është dashur të jepen Çmimet në çdo pozicion veç e veç, që në fund të jetë çmimi në total i Grupimit, dhe pastaj ky çmim total është dashur të vendoset në formatin EXCEL.

Po ashtu pa plotësimin e përshkrimit të çmimeve në dosjen e tenderit nuk është e mundur të vendoset çmimi total i grupimit në formatin EXCEL, pa u vendosur çmimi nëpër pozicione, pra për njësi, kur dihet se çmimi për njësi mbizotëron dhe shërbimi duhet të kryhet me çmimin e ofruar për njësi.

Duke u bazuar në këtë dëshmi rezulton se ky grup i operatorëve ekonomik nuk ka ofruar çmim fare, duke mos u plotësuar formulari i tenderit siç duhet, ndërsa Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP) në nenin 39 Sqarimi i tenderit paragrafi 39.8 përshkruan në këtë mënyrë:

Formulari i tenderit nuk është plotësuar siç duhet – Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Poashtu nëse e shikojmë formatin EXCEL të përshkrimit të çmimeve të plotësuara nga ky grup i operatorëve ekonomik nëse e mbledhim gjitha grupimet si total del oferta prej 1.88 Euro dhe kësaj vlere nuk i është shtuar TVSH, pra TVSH në formularin e ofertës është 0.00 Euro, gjë që është kundërligjore oferta pa TVSH. Nëse i shtohet edhe vlera e TVSH kësaj oferte del të jetë 1.88 *18%= 2.22 Euro dhe në këtë rast shihet që ky grup i operatorëve ekonomik ka bërë gabime aritmetike gjatë llogaritjes së ofertës më shumë se +-2%.

Kur merret parasysh ky fakt rezulton se ky OE ka bërë gabime aritmetikore më shumë se +-2%, dhe në këtë rast është shkelur Neni i 41 i RRUOPP paragrafi 41.8 pika II ku thuhet:

ii. Ne rast se shuma e korrigjuar është më shumë se +/-2%, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B42.

Eksperti i OSHP-së sqaronse në pretendimin e OE ankues se Grupi i Operatorëve nuk e ka të bashkangjitur Përshkrimin e çmimeve, por vetëm totalin e ka të bashkangjitur në dosjen e tij gjë që qëndron pretendimi ankimor pasi që nuk mund të dihet se me çfarë çmimi për njësi ka ofertuar në pozicionet që AK i ka kërkuar në dosjen e tenderit, ku është obligative që të plotësohet përshkrimi i çmimeve në njësi e më pastaj totali të vendoset në tabelën finale.
Pra, Grupi i operatorëve nuk e ka llogaritur vlerën e TVSH-së në totalin e vlerës.

Pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi ankimor i OE ankues për Grupin e Operatorëve

ANKESA PËR GRUPIN E OPERATORËVE EKONOMIK N.N.SH. Vizion Projekt & NP. ART PROJECT

SHKELJA 1
Grupi i Operatorëve ekonomik NNSH Vizion Project & NP ART PROJECT nuk e kanë plotësuar përshkrimin e çmimeve që ndodhet në dosjen e tenderit, pra ***mungon*** kjo pjesë dhe nuk është ngarkuar në platformën elektronike, prandaj njëjtë si operatori ekonomik i lartëcekur NTSH Infratek&A2 Enginiering SHPK ky operator ekonomik nuk e ka plotësuar formularin e tenderit, prandaj kjo ofertë konsiderohet e papërgjegjshme.

Me këtë fakt rezulton se ky operator ekonomik nuk ka ofruar fare çmim, sepse tek rubrikat çmimet për njësi nuk i ka plotësuar fare rubrikat, prandaj për këtë arsye konsiderohet i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar pjesën kryesore të dosjes së tenderit, pra formularin C – pjesa e çmimeve. Ndërsa në nenin 28.14 të RrUOPP shkruan: "Furnksioniivetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmim më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet në bazë të çmimit të ofertuar. Çmimi total i poentuar (peshuar) lexohet gjatë procesit të hapjes

së ofertave. Në këtë rast nuk është ofruar çmim për pozicione - për njësi, kurse në këtë tender nuk dihet numri i sasive të sakta, ndërsa nëse supozojmë se se fituesi i kontratës do të jetë ky operator, atëherë shtrohet pyetja si ka mundësi të bëhet pagesa p.sh. nëse kryhen shtatë (7) shërbime në pozicionin katër (4), kurse 20 shërbime në pozicionin dy (2) (pa u ditur çmimi për njësi)?

Ky grup i operatorëve e ka ngarkuar vetëm formatin e EXCELIT gjë që është e papranueshme sepse në formatin e EXCELIT janë vetëm pozicionet e grupimeve totale, pra së pari është dashur të plotësohet përshkrimi i çmimeve në dosjen e tenderit, pra është dashur të jepet çmimi në çdo pozicion veç e veç, që në fund të jetë çmimi total i grupimit dhe pastaj ky çmim total është dashur të vendoset në formatin EXCEL.

Po ashtu pa plotësimin e përshkrimit të çmimeve në dosjen e tenderit nuk është e mundur të vendoset çmimi total i grupimit në formatin EXCEL, pa u vendosur çmimi nëpër pozicione, pra për njësi, kur dihet se sipas nenit 59.3 të LPP-së, çmimi për njësi mbizotëron dhe shërbimi duhet të kryhet me çmimin e ofruar për njësi.

Duke u bazuar në këtë dëshmi rezulton se ky grup i operatorëve ekonomik nuk ka ofruar çmim fare, duke mos u plotësuar formulari i tenderit siç duhet, ndërsa Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik (RrUOPP) në nenin 39 Sqarimi i Tenderit paragrafi 39.8 përshkruan dhe përcakton qartë:

Formulari i tenderit nuk është plotësuar siç duhet – Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

SHKELJA 2

Marrëveshja e konzorciumit është shumë e mangët me një faqe dhe nuk e përmbush kërkesën e AK-së për formimin e konzorciumit.

SHKELJA 3

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek neni 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar:
2.Një inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Infrastrukturë Rrugore me përvojë pune në projektin minimum 5 vite pas:

Dhe si dëshmi është kërkuar:

-Diplomat (e noterizuar origjinale);
-CV-të (origjinal+të nënshkruar nga vetë pala);
-Referenca në Hartim të projekteve;
-Kontrata valide pune tek operatori ekonomik si staf i rregulltë profesional ose para-kontrata e punës për projektin në fjalë për stafin profesional që nuk janë staf i operatorit ekonomik;

Duke u bazuar në kërkesat e lartëshënuara, grupi i Operatorëve ekonomik NNSH Vizion Project & NNP ART PROJECT në listën e stafit, për kërkesën në lidhje me : Inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Infrastrukturë Rrugore me përvoj pune min.5 vite, ka ofruar një Inxhinier të Universitetit Politeknik të Tiranës – Fakulteti i Inxhinierisë së ndërtimit drejtimi transport, e që ky inxhinier nuk është Inxhinier i drejtimit Infrastrukturë Rrugore ashtu siç është kërkuar në FDT. Në listën e stafit të grupit të operatorëve ekonomik ky inxhinier është me nr.rendor 2 (DenisJano).

SHKELJA 4

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek neni 9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar:

Kërkesa 2 – Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, Hartim projekteve (rruge, ujësjelles, kanalizim, matje gjeodezike, parqe, kanale të ujitjes,

hapsiragjelbëruese, objekte shkollore-administrative-kulturore, salla sportive etj), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min.180,000.00 €.
Dhe si Deshmi është kërkuar:

Deshmia 2 – Lista e kontratave origjinal e nënshkruar dhe vulosur. Për cdo projekt, të bëhet përshkrimi me këto informata titullin e kontratës, autoritetin kontraktues, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës dhe rolin e operatorit ekonomik në zbatimin e kontratës (lider apo partner). Referencat apo certifikatat për kryerjen e punëve, kopje e prezantuara në listën e kontratave.

Nëse shohim listën e kontratave te prezantuara nga ana e Liderit te konzorciumit NNSH Vizion Project, shihet qe nuk e ka bere ne formën sic e ka kërkuar AK, dhe si e tille nuk mund te merret parasysh nga AK.

Nëse shohim listën e kontratave te prezantuara nga ana e anëtarit tjetër të konzorciumit NP ART PROJECT shihet që shuma e kontratave është në vlerën 124,841.14 Euro dhe nuk e plotëson kërkesën e specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës, ku është kërkuar që vlera minimale e projekteve te jete min.180,000.00 Euro.

Në vendimin e AK-së të datës 07.05.2019 për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim Autoriteti Kontraktues e ka pranuar faktikisht që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi për inxhinierin e ndërtimtarisë së Infrastrukturës rrugore dhe nuk ka ofruar dëshmi për agronom apo kimist, por i ka marr për bazë lëmitë dhe drejtimet tjera në mënyrë të kundërligjore dhe në kundërshtim me kërkesat e FDT-së.

Njëkohësishtë për pretendimin tonë lidhur me mungesën e ISO standardeve të OE te rekomanduar per kontrate, vetëm e kane shënuar se i kane dhe ne asnjë menyre nuk kane arritur të Dëshmojnë se ka ISO certifikata.

Edhe pretendimet tona tjera, autoriteti kontraktues në vendimin e lartepermdnur i ka refuzuar pa ofruar ndonjë dëshmi apo prove konkrete.

Ndërsa pretendimet tona për të dy operatoret ekonomik tjerë NTSH. Infratek&A2 Enginiering SHPK dhe NNSH. Vizion Project &ART PROJECT, se nuk i kane plotësuar përshkrimin e çmimeveqe ndodhen ne dosjen e tenderit, autoriteti kontraktues i ka pranuar si te qëndrueshme, prandaj rezulton se edhe per OE e rekomanduar per kontrate edhe per dy operatoret e tjerë faktikisht, autoriteti kontraktues e ka pranuar se nuk i plotësojnë te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate. Poashtu nuk eshte bere poentomi sipas Nenit 30.1 te FDT-se. Poashtueshte shkelur edhe neni 41i RRUOPP.

Gjithashtu janë shpallur të përgjegjshëm edhe dy operatorët ekonomik tjerë NTSH. Infratek&A2 Enginiering SHPK dhe NNSH. Vizion Project &ART PROJECTte cilët faktikisht nuk i kane plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, ashtu siç janë kërkuar dhe siç parashihet në nenin 64 të LPP-së, përkitazi me nenin 69 të LPP-së, prandaj edhe në këtë rast nuk është respektuar neni 59.4 i LPP-së.

Me këtë rast ne jemi diskriminuar, ndërsa është favorizuar OE i rekomanduar për kontratë në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Eksperti i OSHP-së sqaron se: Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues deklaron se Grupi i Operatorëve ekonomik NNSH Vizion Project & NP ART PROJECT nuk e kanë plotësuar përshkrimin e çmimeve që ndodhet në dosjen e tenderit, pra ***mungon*** kjo pjesë dhe nuk është ngarkuar në platformën elektronike, prandaj njëjtë si operatori ekonomik i lartëcekur NTSH Infratek&A2 Enginiering SHPK ky operator ekonomik nuk e ka plotësuar formularin e tenderit, prandaj kjo ofertë konsiderohet e papërgjegjshme.

Me këtë fakt rezulton se ky operator ekonomik nuk ka ofruar fare çmim, sepse tek rubrikat çmimet për njësi nuk i ka plotësuar fare rubrikat, prandaj për këtë arsye konsiderohet i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar pjesën kryesore të dosjes së tenderit, pra formularin C – pjesa e çmimeve. Ndërsa në nenin 28.14 të RrUOPP shkruan: "Funksioni ivetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmim më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet në bazë të çmimit të ofertuar. Çmimi total i poentuar (peshuar) lexohet gjatë procesit të hapjes

së ofertave. Në këtë rast nuk është ofruar çmim për pozicione - për njësi, kurse në këtë tender nuk dihet numri i sasive të sakta, ndërsa nëse supozojmë se se fituesi i kontratës do të jetë ky operator, atëherë shtrohet pyetja si ka mundësi të bëhet pagesa p.sh. nëse kryhen shtatë (7) shërbime në pozicionin katër (4), kurse 20 shërbime në pozicionin dy (2) (pa u ditur çmimi për njësi)?

Pra, pas shiqimit të dokumentacionit të dosjes së tenderit së tenderit të Grupit të Operatorëve ekonomik me këtë deklarojmë se sic pretendon OE ankues, se Grupi i Operatorëve nuk e kanë tëbashkangjitur në dosjen e tenderit përshkrimin e çmimeve por e kanë të bashkangjitur vetëm tabelën finale (totalin) e përshkrimit te çmimeve, ku OE nuk e ka shënuar vlerën e TVSH-së për çdo pozicion, pra nuk e ka llogaritur fare TVSH-në.
Pra, Nese nuk plotësohet përshkrimi i çmimeve baze, atëherë nuk ka efekt plotësimi i totalit ne sistem, sepse nëse nuk plotësohen sic duhet, nuk dihet vlera që ka ofertuar OE dhe nuk ka mundësi pagese të ndonjë pozicioni, nëse nuk figuron asnjë pozicion detal në dosje.

Këtë e precizon neni 18 i RrUOPP-së

1/Grupi i operatorëve e ka plotësuar vetëm totalin e paraqitur ne e-prokurim, kurse nuk e ka plotësuar përshkrimin e çmimeve per njësi, pasi qe pretendimi i OE ankues eshte i bazuar pasi qe nëse kryhen me shume shërbime nuk ka çmim referues se sa do te jete shërbimi. Ne formularin qe e ka plotësuar ky konzorcium nuk e ka vendosur vlerë për TVSH-në, por e ka vendosur 0.00 €. Pra nuk eshte i plotësuar Pershkrimi i çmimeve per njësi.

2/Sa i perketë marrëveshjes se konzorciumit Grupi i Operatoreve e ka plotësuar dhe nënshkruar marrëveshjen, por me disa lëshime qe mund ti konsiderojmë si devijime te vogla.

3/Sa i përket inxhinierit te Infrastruktures rrugore, Grupi i OE ka paraqitur ne listën e stafit Diplomen e Masterit te Ndertimit per z.Denis Franc Jano – profili TRANSPORT i diplomuar ne Universitetin Politeknik te Tiranes (UPT), data e lëshimit te diplomës 24.11.2012, me nr.diplomes M-416.

4/Kurse sa i përket pretendimit ankimor sipas FDT-së Neni 9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar:

Kërkesa 2 – Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, Hartim projekteve (rruge, ujësjelles, kanalizim, matje gjeodezike, parqe, kanale të ujitjes, hapsira gjelbëruese, objekte shkollore-administrative-kulturore, salla sportive etj), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min.180,000.00 €.

Dëshmia 2 Lista e kontratave origjinal e nenshkruar dhe vulosur. Percdo projekt, te behet pershkrimi me keto informata titullin e kontrates, autoritetin kontraktues, daten e fillimit te kontrates, daten e perfundimit te kontrates, vleren e kontrates dhe rolin e operatorit ekonomik ne zbatimin e kontrates (lider apo partner). Referencat apo certifikatat per kryerjen e puneve, kopje per kontratat e prezentuara ne Listen e kontratave.

Eksperti i OSHP-së bazuar nëkërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontratë, sipas dokumenteve të bashkangjitura nëdosjen e tenderit konstaton se:
Te pretendimi i OE ankues në listën e projekteve, OE "Vizion Projekt" nuk e ka paraqitur *Listen e qartë* ashtu siç e ka kërkuar AK-Komuna Klinë (citim): **Dëshmia 2 Lista e kontratave origjinal e nenshkruar dhe vulosur.Percdo projekt, te behet pershkrimi me keto informata titullin e kontrates, autoritetin kontraktues, daten e fillimit te kontrates, daten e perfundimit te kontrates, vleren e kontrates dhe rolin e operatorit ekonomik ne zbatimin e kontrates (lider apo partner)**", por ne listën e OE. "Vizion Projekt" ka disa mangësi qe nuk e ka paraqitur konform kërkesës së AK-së si: *Daten e fillimit dhe datën e përfundimit (në cilën datë e ka nënshkruar kontratën dhe cilën datë skadon kontrata) dhe nuk e ka cekur emrin e OE ose konzorciumit etj.AK mund ta krahasoj një kontratë varësishtë periudhës se ekzekutimit psh. Nese kontrata eshte nënshkruar me 05 Qershor te vitit 2013 dhe përfundon me 05 Qershor të vitit 2016, te merret parasysh vetëm vlera e kontratës e përfunduar jo me shume se 3 vite para njoftimit per kontrate, psh. Nëse oferta eshte hapur ne Maj 2019, duhet te merret parasysh projektet qe janë kryer nga muaji maj 2016 e jo e gjithë kontrata!*

Lista e projekteve të ofertuesit OE. "Vizion Projekt"i ka këto te dhëna: Numri; Pershkrimi i kontratës; Data e fillimit dhe mbarimit (ku OE e ka cekur vetëm vitin e fillimit dhe skadimit); Autoriteti kontraktues dhe vendi i realizimit të punëve; Emri dhe nr.i personit kontraktues (dmth.emri i zyrtarit të AK-së), dhe vlera e kontratës. Pra, këto të dhëna i përmban lista e projekteve të OE. " Vizion Projekt"-Prishtinë. Pra, nuk eshte lista siç është kërkuar por është pjesërisht sipas kërkesave te AK-së.

Kurse OE "ART PROJEKT" e ka paraqitur listën e qarte ashtu siç e ka kërkuar AK ne kriteret e FDT-së
Pra, AK mund ta merr parasysh gjate procesit te rivlerësimit dhe tekrahasoj listën e dy OE-ve sipas kërkesës se AK dhe listës se prezantuar te OE-ve ofertues.

Pretendimi ankimor i OE ankues pjesërisht i bazuar.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet e bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet ankimore te paraqitura ne raport),propozojmeqë të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.